

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 12 MAJ 2022

E nderuar zonja Kryetare e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

E mirëkuptoj prioritetin e parafolësit për çështjet që ngriti, por dua të kthej përsëri vëmendjen të një prioritet po aq i rëndësishëm, i cili duhet të marrë vëmendjen e gjithë anëtarëve të këtij parlamenti të nderuar, të qeverisë dhe të të gjithë qytetarëve. Lidhur me marrëveshjen, dua të sjell disa shifra, të cilat janë të vështira për t'u gjestionuar, por duhet t'i ballafaqojmë të gjithë së bashku. Sipas INSTAT-it në vitin 2019, 52% e grave në moshën 15-74 vjeç kanë vuajtur një ose më shumë formë violence nga partnerët më të afërt. Ajo që është më shqetësuese, një ndër dy gra pranojnë se kjo është një normë sociale, sepse kjo mund ta mbajë familjen të bashkuar.

Vijmë dhe flasim në parlament për në parlament për të drejtat e gruas dhe e kuptojmë se një pjesë e rëndësishme e atyre që përfaqësojmë jo vetëm në qytet, por sidomos në zonat rurale, në qytetet më të largëta, vuajnë dhunën, vuajnë padrejtësinë, vuajnë mungesën e ngritjes së zërit. Në vite mbështetja për barazinë gjinore nuk ka ardhur vetëm si një mbështetje për një hua në buxhetin e shtetit, por ka ardhur, mbi të gjitha, si një nevojë për ta bërë zërin e gruas të dëgjohet dhe kjo përqindje, siç e thashë pak më parë, pra 52% të ulet dhe, mbi të gjitha, të pranohet fakti që kjo normë sociale të zhduket. A është bërë mjaftueshëm? Së pari, duhet të themi se është bërë diçka. Megjithatë, besoj se është bërë më shumë se diçka.

Në 9 vjetët e fundit, duke filluar nga viti 2013 deri në vitin 2020, të paktën për referencë të shifrave më të fundit të buxhetit të shtetit, 9% e buxhetit të shtetit ka shkuar për mbështetjen e programeve që vënë në fokus barazinë gjinore, nga 1% që ka qenë në viti 2013. 9% e buxhetit të shtetit është për vëmendjen ndaj barazisë gjinore dhe 47 programe janë përcaktuar tekstualisht për barazinë gjinore. A është e mjaftueshme? Jo, ne sot humbasim 20% të produktit të brendshëm bruto, si rezultat i mospërfaqësimit të gruas në sipërmarrje. Nëse flasim me statistikat e sipërmarrjes, vetëm 25% e grave janë sot pronare të biznesit. Pse të mos jetë më shumë?! Si do të arrijmë të ketë zë gruaja, nëse nuk do të jetë e pavarur ekonomikisht?!

Ne do të bëjmë shumë më tepër, përveç atyre që janë bërë deri sot, për të rritur zërin e gruas, për ta bërë atë më të pavarur, për ta bërë gruan, sidomos atë që punon nga Veriu në Jug në atë që është trashëgimia familjare në punën artizanale, të bashkohet, të krijojë vlera, të ketë mundësi të aksesojë grante dhe mbështetje, sidomos të ketë akses në financa, të cilat edhe më herët, por sidomos në vitet në vijim duhet ta shtojmë vëmendjen ndaj gruas, ndaj gruas sipërmarrëse, të kemi mundësi që handikapi e përfaqësimit të gruas në biznes ta ngushtojmë në atë përqindje që ekziston në edukim, në arsim si dhe shëndetësi. Ndoshta për arsye të trashëgimisë ne sot kemi një gap shumë të vogël në arsimimin dhe adresimin e mbështetjes në shëndetësi për barazinë gjinore, pra është diku te 0,9-0,8%, ndërkohë është shumë i lartë në pjesën ekonomike.

Sot flasim për mbështetjen e qeverisë me programe, kryesisht mbështetjen me hua. Është shumë e rëndësishme, sepse këtu nuk jemi vetëm, nuk kemi vendosur ta mbështesim sot barazinë gjinore, por me herët nga Banka Botërore, si dhe me këtë marrëveshje, që do të firmosë Agjencia Franceze e Zhvillimit, të cilat e kanë ndihmuar qeverinë shqiptare. Shpresoj që të dinamizohet më tej mbështetja për përfaqësimin e gruas në shoqëri, në ekonomi që të bëhet me e denjë, të dalë e pavarur dhe të ketë mundësi t'i aksesojë të gjitha të drejtat në mënyrë të barabartë, për të rritur zërin e saj, ekonominë e saj dhe mbështetjen sociale në familje dhe në të gjithë shoqërinë. Faleminderit!